

VENDIM
Nr. 13, datë 26.1.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA PËR SHTYRJE TË AFATIT TË
VENDIMMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBGAZ” SHA NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 128/1 prot., datë 21.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- ERE, me vendimin nr. 195, datë 22.9.2021, ka vendosur për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri më datë 20.1.2022. Në kuptim të këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese, mbi të gjithë dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim, me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s nëpërmjet postës zyrtare elektronike, më datë 20.1.2022, duke argumentuar se, në kuadër të plotësimit të dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, aktualisht po punon mbi raportin final “*WB20-ALB-ENE-01 Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage*”, i cili përmbush kërkesat e paplotësuara për këtë procedurë. Këtë drafraport shoqëria “Albgaz” sh.a. e ka depozituar edhe në ERE. Në këto kushte, shoqëria kërkon mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale, për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror të “Albgaz” sh.a., deri më datë 20.12.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, brenda afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195, datë 22.9.2021, dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “Albgaz” sh.a. për të plotësuar kushtet respektive, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimmarrjes, për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri më datë 20.12.2022.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti